LIGJ
Nr.9795, datë 23.7.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9109, DATË 17.7.2003 "PËR PROFESIONIN E AVOKATIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9109, datë 17.7.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 pika 1 ndryshohet si më poshtë:
"1. Avokati ushtron profesionin e tij individualisht ose në bashkëpunim me avokatë të tjerë, pasi është pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit dhe është regjistruar në organet tatimore.
Avokatët mund të organizohen në zyra avokatie, të cilat regjistrohen në organet tatimore.".

Neni 2

Në nenin 5, në fund të pikës 1 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
"Në çdo rast, avokati, në ushtrimin e profesionit, identifikohet me numrin e lejes së ushtrimit të profesionit, si dhe kodin fiskal të tij apo të zyrës së avokatisë ku bën pjesë.".

Neni 3

Në nenin 24, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:
"2/1 Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë miraton hapjen e zyrës së avokatisë, pas regjistrimit të saj në organet e regjistrimit të biznesit, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.".

Neni 4

Në nenin 25, pas shkronjës "e" shtohet shkronja "ë" me këtë përmbajtje:
"ë) të jetë pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit të avokatit dhe të jetë regjistruar në organet tatimore.".

Neni 5

Në nenin 38 pika 1 shkronja "a", pas fjalëve "veprimtarinë e avokatisë" shtohen fjalët "dhe legjislacionin tatimor".

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5450, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi